



Nr. Ref. BD-165/1

Në bazë të nenit 15.2.15 dhe 20.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 22 qershor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Buxheti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin fiskal 2023.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

Arsyetim

Në mbledhjen e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të mbajtur me 22 qershor 2022, Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e buxhetit të AKP-së për vitin 2023.

Menaxhmenti i kishte paraqitur Bordit rekomandimin për aprovimin e buxhetit për vitin 2023 sipas kërkesave buxhetore të mbledhura nga të gjithë mbajtësit e buxhetit, të cilat pastaj janë analizuar në secilën linjë buxhetore për vitin 2023 si dhe në parashikimet e hershme për vitet 2024-2025. Gjatë procesit të përgatitjes së kërkesës buxhetore janë analizuar edhe shpenzimet e vitit të kaluar, shpenzimet e deritanishme si dhe kodet ekonomike të cilat janë të nevojshme për realizimin e shpenzimeve gjatë vitit vijues si dhe janë bërë korrigjimet e nevojshme.

Bordi shqyrtoi buxhetin e propozuar nga Menaxhmenti, dhe duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 22 Qershor 2022.



Nazmi Mikullovc
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-165/2

Në bazë të neneve 11.6 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 22 qershor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet plotësim-ndryshimi i tabelës 6.3 të Rregullores së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë, ku pozita e Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm pozicionohet në gradë/hap 2-9.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së vendimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për nivelizimin e pagës për pozitën e Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm me të cilin kjo pozitë do të pozicionohet në gradë/hap 2-9 në Rregulloren e Pagave të AKP-së.

Bordi konsideroi që duke marrë parasysh se Agjencia është duke kaluar nëpër një fazë të ristrukturimit të përgjithshëm, një nivelizim i këtillë parcial nuk i kontribuon procesit të përgjithshëm të ristrukturimit dhe riorganizimit të Agjencisë.

Për këto arsye, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 22 qershor 2022.

Nazmi Mikullovi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-165/3

Në bazë të nenit 15.2.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publik, dhe Rregullores e Qeverisë Nr. 15/2020 për Pranimin, vlerësimin dhe disiplinën e nëpunësve të lartë drejtues, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 22 qershor 2022 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Bordi zgjedh dhe emëron **Z. Arben Limani** në pozitën e **Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit**.
- II. Mandati i të emëruarit sipas pikës I të këtij vendimi është 4 (katër) vite duke filluar nga data **05.07.2022** dhe kompensimi për të njëjtin bëhet sipas Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Në mbledhjen e mbajtur me 22 qershor 2022, Bordi diskutoi lidhur me raportin përfundimtar të Komisionit të Pranimit për pozitën e Drejtorit Menaxhues të AKP-së të datës 8 prill 2022, dhe në zbatim të vendimit A.nr.393/2022 të datës 14 qershor 2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Bordi përzgjedhi z. Arben Limani si kandidat fitues dhe të njëjtin e emëroi në pozitën e Drejtorit Menaxhues të AKP-së me mandat 4 (katër) vjeçar duke filluar nga data 5 korrik 2022. Arsyeja për fillimin e mandatit nga data 5 korrik është për të lejuar një periudhë transitore për shkak të disa proceseve të cilat janë filluar më herët.

Për këto arsye, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 22 qershor 2022.



Nazmi Mikullovi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



1 / 1